



KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

## KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Gjakovë-Djakovica-Gjakova  
Kuvendi i Komunës së Gjakovës  
01 Nr. /2020  
Datë: 30.01.2020

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 5, 6, 8 dhe 14.3 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2020 pas diskutimit lidhur me pikën 10 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale –parkingjeve, e miratoi këtë:

### VENDIM

#### Paraparak

për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës Komunale

1. Miratohet vendimi paraparak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale – Parkingjeve me nr. të parcelave: P-70705029-05831-1 Z.K Qytet, P - 70705029 - 05826-1 Z.K Qytet, P-70705029-03495-69 Z.K Qytet, P-70705029-05833-2, Z.K Qytet, P-70705029-05829-2, Z.K Qytet, P-70705029-05765-1 Z.K Qytet, P-70705029-05765-4 Z.K Qytet, të cilat janë në Pronësi të Komunës së Gjakovës .
2. Afati kohor për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale - Parkingjeve është afatshkurtër.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzimin të pronave- Parkingjeve është funksionalizimi i tyre, dhe përfitimi ekonomik i komunës nga prona komunale.
4. Procedura për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes njoftimit publik në harmoni me nenin 15 të ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .
6. Vendimi iu dërgohet:
  - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
  - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal .
  - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë .
  - Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit .
  - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
  - Arkivit.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Z. Anton Shala